

Pjerina Gaxha

Mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Mbrojtjes së të Dhënave Personale në Zyrën e Komisionerit. Ka një karrierë të gjatë pranë Autoritetit, pasi më parë ka qenë pjesë e Drejtorisë së Hetimit Administrativ, si edhe Drejtorisë së Procedurave Ligjore dhe Marrëdhënieve me Jashtë. Është diplomuar si juriste pranë Fakultetit të Drejtesisë të Universitetit të Tiranës. Ka Master në Adiministrim Publik, pranë Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës. Është e pajisur me licensë avokatie nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Eksperienca të mëparshme të punës kanë qenë si pjesë e sektorit juridik pranë Agjencisë Kombëtare të Turizmit, Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, etj. Gjithashtu, ka eksperiencë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, gjatë angazhimit të saj profesional pranë Autoritetit francez të Mbrojtjes së të Dhënave Personale – CNIL; si juriste dhe As/avokate në dy projekte të UNHCR dhe Terre des Hommes.

Artan Gjylbegaj

Mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Hetimit Administrativ në Zyrën e Komisionerit. Është diplomuar në Fakultetin e Shkencave Politike-Juridike, dega Drejtësi, të Universitetit të Tiranës në vitin 1986.

Ka një karrierë të gjatë në sistemin e drejtësisë si gjyqtar, prokuror, avokat e noter. Ka mbajtur më parë funksionet e Kryeregjistruesit në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të Drejtorit të Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ pranë Kryeministrit, si edhe të këshilltarit ligjor në Gjykatën e Lartë. Gjatë karrierës së tij, z. Gjylbegaj ka kryer trajnime të shumta në fushën e jurisprudencës.

Anola Xhuli

Mban postin e Drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Juridike në Zyrën e Komisionerit. Është diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës në vitin 1996. Znj. Xhuli ka përfunduar Master në Administrimin e Institucioneve Sociale në sistemin e drejtësisë, i organizuar nga Fakulteti i Drejtësisë në bashkëpunim me Fakultetin e Shkencave Sociale, me mbështetjen e OSBE. Në karrierën e saj, ka ushtruar profesionin e ndihmës gjyqtarit në Gjykatën e Shkallës së Parë të Tiranës, shefit të Sektorit për të Drejtat e Minorenëve dhe Përafrimin e Legjislacionit në Drejtorinë e Shërbimeve Juridiko-Administrative në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe të Inspektorit në Drejtorinë e Inspektimit Gjyqësor në këtë Ministri.

Znj. Xhuli është e licensuar në profesionin e avokatit, ka qenë prej vitit 2001-2005 anëtare e Komitetit Shqiptar të Birësimeve, është trajnere në fushën e të drejtave të minorenëve dhe së fundi, edhe trajnere në sferën e mbrojtjes së të dhënave personale. Znj. Xhuli ka përfituar disa trajnime brenda dhe jashtë vendit në fushën civile, penale, familjare, tregtare, atë të arbitrazhit, si dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Irma Arapi

Mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Jashtë në Zyrën e Komionerit. Është diplomuar në vitin 2003 në Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës. Znj. Arapi, gjithashtu, ka mbrojtur edhe Masterin Shkencor “Për të drejtën publike”. Gjatë periudhës mes viteve 2004-2015 ka ushtruar detyrën e Kancelarit në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor të Vlorës dhe në atë të Fierit. Gjatë karrierës së saj, znj. Arapi ka kryer disa trajnime në fushën e jurisprudencës.

Lindita Morina

Mban pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve të Brendshme dhe Financës në Zyrën e Komisionerit. Është diplomuar në vitin 1987 në Fakultetin e Ekonomisë së Universiteti të Tiranës. Prej këtij viti, znj. Morina, ka ushtruar disa funksione pranë institucioneve si: ish-INIMA (Instituti i Informatikës dhe Matematikës së Aplikuar), Ujësjiellës-Kanalizime Tiranë dhe në Agjencinë Kombëtare të Turizmit. Prej vitit 2008, znj. Morina, është pjesë e stafit të Zyrës së Komisionerit.

Ardita Shehaj

Mban pozicion e Drejtorit të Drejtorisë për të Drejtën e Informimit. Ka një karrierë 2-vjeçare pranë Zyrës së Komisionerit. Më parë ka ushtruar funksionin e Inspektorit në Drejtorinë e Mbikqyrjes dhe Hetimit të Tregjeve, pranë Autoritetit të Konkurrencës. Ka një karrierë 8-vjeçare në fushën e mësimdhënies, si pedagoge e jashtme në lëndën Makro-ekonomi në Fakultetin e Ekonomisë.

Është diplomuar si ekonomiste pranë Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Ka titullin Master në Studime Ekonomike Evropiane, pranë Fakultetit të Ekonomisë si dhe është duke vazhduar studimet për titullin Doktor Shkencash në Fakultetin e Ekonomisë. Gjatë karrierës së saj, znj. Shehaj, ka kryer disa trajnime në fushën e të drejtës për informim dhe antikorrupsionit, duke marrë së fundmi, nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike dhe OSBE, titullin “Trajner në fushën e antikorrupsionit dhe mirëqeverisjes”. Gjithashtu, është trajnere për çështjet e të drejtës për informim pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike.